

TEXHVIDI KARABASH



Botim i Fazilet Neşriyat / 240

TEXHVIDI KARABASH

Përgatiti

Fazilet Neşriyat

Grafika / Dizajni

Fazilet Neşriyat Grafik Servisi

Printimi dhe Faqosja

Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş.

Numri i Botimit No: 46592



FAZILET
NEŞRİYAT

ISBN

978-625-8027-33-4

BOTIMI

Stamboll, 2023

Kontakt

Bağlar Mah. Mimar Sinan Cad.

No: 54 Güneşli - Bağcılar / İSTANBUL

Tel: 0212 657 88 00

www.fazilet.com.tr

bilgi@fazilet.com.tr

Ky libër është një përkthim i librit "Karabaş Tecvidi" i botuar në gjuhën turke.

© Të gjitha të drejtat e kësaj vepre janë të rezervuara në emër të Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş.

Fazilet Neşriyat është një markë e Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş.

TEXHVIDI
KARABASH

PARATHËNIE

Lavdërimi i takon Allahut të Madhëruar, i cili prej robërve të tij zgjedh trashëgimtarët e librit të Kuranit famëlartë dhe ua obligon ta lexojnë Kuranin me texhvid dhe të veprojnë sipas tij. Salat-i dhe Selami i shkojnë Pejgamberit tonë, i cili lexoi Kuranin në mënyrën më të bukur dhe ia mësoi umetit të tij bi'l-mushafehe (me gojën e tijë). Paqja qoftë mbi Muhamed Mustafan (a.s), familjen dhe shokët e tij që janë në rrugën e drejtë.

Kuptimi gjuhësor i fjalës **Texhvid**, do të thotë, të bësh diçka në mënyrë të bukur dhe të hijshme.

Ndërsa në shkencën e kiraetit (këndimit të Kur`an-it Kerim) ka kuptimin e shqiptimit të germave nga vendi i duhur në mënyrën e duhur. Sipas këtij parimi, kuptimi i texhvid`it është të shqiptosh germat ashtu siç duhet, pra sipas rastit me forcë, me lehtësi, me butësi, me harmoni, me thjeshtësi etj. **E shprehur më qartë, texhvid`i është shkenca që të mëson si të këndosh Kur`an-in Kerim sipas rregullave të caktuara...Ndryshe, texhvid është titulli i librit të shkruar mbi këtë shkencë.**

Qëllimi i texhvid`it është të mbrojë gjuhën nga të gjitha gabimet e mundshme gjatë këndimit të fjalës së All-llah`ut.

Ekzistojnë tre metoda të këndimit të Kur`an-it Kerim:

Tertil; Të lexosh duke i shqiptuar fjalët një e nga një, ngadalë ngadalë, në mënyrë të qartë dhe duke u ndaluar në vendet ku duhet ndaluar, të lexosh duke menduar për kuptimin...

Hadr; të lexosh me shpejtësi, por duke respektuar rregullat e texhvid`it...

Por nuk duhet të shpejtohet aq shumë sa të ngatërrohen fjalët me njëra tjetrën. Mënyra e leximit duke u ngatërruar fjalët me njëra tjetrën quhet Hadhrame dhe kjo nuk është një mënyrë e përshtatshme leximi. Në lidhje me këtë Hazreti Omeri (r.a.) ka thënë: “Udhëtimi më i keq është ta ngasësh kafshën aq shpejt sa të rraskapitet;

Kiraeti (mënyra e leximit) më i keq është të lexosh aq shpejt sa të ngatërrohen fjalët me njëra tjetrën.”

Tedvir; kjo mënyrë leximi nuk është as shumë e shpejtë dhe as shumë e ngadaltë, por është rruga e mesme mes tertil dhe hadr. Kjo është mënyra më e preferuar nga mjeshtrat e këndimit të Kur`an-it Kerim.

Në të tre mënyrat e leximit, duhet të lexohet me texhvid (sipas rregullave), duke i shqiptuar gërmat ashtu siç duhet. Sepse All-llahu i Madhëruar ka thënë:

“...këndoje Kur`an-in Kerim me tertil.”¹ Kur e pyetën **Hazreti Ali`un** (k.v.) se cili ishte kuptimi i fjalës

¹ Sureja Muzzemmil, Ajeti 4

tertil, ai është përgjigjur: “**Tertil do të thotë të dish mirë texhvid`in (shqiptimin e duhur) e fjalëve dhe vendet ku duhet ndaluar.**”²

E shohim të arsyeshme që në këtë pikë të përmendim një ngjarje mbi rëndësinë e texhvid`it:

Përmbledhësi i librit kryesor nga gjashtë librat e njohur të haditheve, i nderuari Ismail Buhari (rh.), i shqyrtonte me kujdes të gjitha argumentet e një hadithi të transmetuar prej Pejgamberit tonë të nderuar (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Nëse kjo fjalë shkonte pa asnjë ndërprerje deri tek Resulull-llah`u atëherë merrte gusul dhe shtrihej të flinte. Pyeste Pejgamberin e nderuar në botën e shpirtave dhe vetëm pasi merrte përgjigjen “Po, kjo është fjala ime” atëherë e shkruante atë fjalë në librin e tij. Një herë e kishte pyetur për hadithin sherif “**الْحَيَاءُ مِنَ الْإِيمَانِ**”³ “**El-Hajau mine`l-iman:** Turpi vjen nga besimi”, por kishte marrë përgjigjen: “Kjo nuk është fjala ime”.

Kontrolloi edhe një herë përmbajtjen dhe transmetimet e hadithit dhe e pyeti përsëri. Edhe këtë herë përgjigja ishte e njëjtë! E shqyrtoi sërish hadithin dhe vuri re se përmbajtja ishte e saktë dhe transmetuesit të besueshëm. Kur e pyeti përsëri për herë të tretë, e lexoi hadithin më me kujdes, duke i`u përmbajtur rregullave të texhvid`it.

Për arsye se është rregull i “Medd-i muttasëll” dhe është vaxhib që të zgjatet fjala “el-Hajaaaaau” “**الْحَيَاءُ**”

² Nihâyetü`l-Kavli`l-Müfid, s.18.

³ Kütüb-i Sitte.